

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, (e vendosur ne objektin e Gjykates ne Vushtri). Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Civil, Gjyqtari Skender Shala, ne qeshtjen juridike te paditeses nga Drenasi, kunder te paditures ne Mitrovice, te cilen e perfaqeson sipas autorizimit me shkrim, lidhur me pagesen e te ardhurave personale, pas mbajtjes se seances te shkqyrtimit kryesor dhe publik me dt.19.05.2015, bie kete:

AKT GJYKIM

- I. **APROVOHET** si e bazuar kerkespadia e paditeses nga Drenasi.
- II. **OBLIGOHET** e paditura ne Mitrovice, qe ne emer te pageses te te Ardhurave Personale per periudhen kohore prej 01. 11.2014 e gjere me daten 31.05.2015, t'ia paguaj paditeses shumen prej 2.996 Euro, ne afat prej 7 (shtat) ditesh, nga dita e plotefugishmerise se Aktgjykimit, nen kercnim te permbarimit me dhune.
- III. Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

Arsyetim

Paditesja ne padine e saj te parashtuar ka theksuar se ajo eshte punesuar ne baze te konkursit ne muajin Nentor te vitit 2014 ne Mitrovice si mesimdhenese e lendes kultura muzikore dhe ku mbane 20 ore mesimi ne jave. Mirepo qe nga data e punesimit e gjere me sot edhe pse kane kaluar afer 7 (shtat) muaj nuk me jane paguar te Ardhurat Personale nga punechensia ne Mitrovice. E njejta shton se ka shkuar shum here ne kete institucion personalisht si dhe nepermes organeve drejtuese te shkolles qe te pyes per shkakun pse ndodh kjo nga zyrtaret e te njejtes kam marre pergjigje se nuk ka kurgja kontestuese me themelimin e marredhenies se punes mirepo arsyetimi i kerkeses per pagesen e te Ardhurave Personale dhe ate me dt. 21.01.2015 drejtuar Komisionit per ankesa i cili nuk i ka kthyer pergjigje as ne afatin ligjor.



Ne seancën e shqyrtimit kryesor e njejtë ka bërë precizimin e kërkespadiës në atë mënyrë që ka kërkuar të aprovohet padia dhe kërkespadija dhe të obligohet e paditura që t'ia paguaj në emër të pagave të papaguara personale Shumen prej 2.996 Euro , dhe atë nga muaji Nëntor deri në muajin Maj perkatesisht për 7 (shtat) muaj.

Në fjalën e saj përfundimtare deklaroi se mbetet në teresi në thenjet nga seanca e shqyrtimit kryesor dhe precizimit të padiës dhe kërkespadiës në seancën e njejtë.

Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Perfaqësuesi I të paditurës në përgjigje të padiës dhe kërkespadiës së paditësës ,ka deklaruar se e kundërshton kërkespadiën e paditësës duke shtuar se jam I vetëdijshëm se e njejtë është pranuar në punë në vendin e punës sipas kontratës, mirepo arsyeja e mospagesës së të Ardhurave Personale në raport me paditësen është mungesa e mjeteve buxhetore në pozicion me pagat dhe se përveç paditësës kemi edhe rastë të tjera të njejtë.

Në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se mbetet në teresi pranë thenjeve në seancën e shqyrtimit kryesor.

Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Gjykata me qëllim të vertetimit të drejtë dhe të plote të gjendjes së faktive për aq sa palet ndërgjyqëse i parashtruan ato dhe propozuan provë për provimin e tyre , në kuptim të nenit 7 të LPK-së, në procedurën e provave në shqyrtimin kryesor të mbajtur më dt. 19.05.,2015, bëri administrimin e provave me leximin e: kontratës mbi themelimin e marrëdhënies së punës më dt. 03.11.2014, kërkesën e paditësës drejtuar në Mitrovicë të dt. 21.01.2015, përgjigjen në kërkesë nga ana e të paditurës në Mitrovicë të dt. 27.01.2015 , ankesën e paditësës drejtuar Komisionit për ankesa pranë të paditurës e dt. 11.02.2015 si dhe vlerësoi deklaratimet e paleve ndërgjyqëse.

Gjykata pasi që bëri analizimin dhe vlerësimin e secilës prove veq e veq e në lidheshmeri njera me tjetren, qmuarjes me kujdes dhe ndërgjegjje , e duke u mbështetur me dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në rastin konkret duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga arsyet si në vijim:

Gjykata ka gjetur faktin e pakontestueshëm se paditësja ka themeluar marrëdhënien e punës në kohë të caktuar duke filluar nga dt. 03.11.2014 e gjere më dt. 31.08.2015, në bazë të kontratës së punës të dt. 03.11.2014 dhe arsimitare e kultures muzikore në



Ne baze te kerkeses te dates 21.01.2015 vertetohet fakti se paditesja iu eshte drejtuar te paditures me kerkesen qe t'i paguhen pagat – te ardhurat personale mujore

Nga pergjegjja ne kerkese e dates 27.01.2015 vertetohet fakti se e paditura nuk e mohon faktin se paditeses nuk iu eshte bere pagesa e te Ardhurave personale sipas kontrates se punes duke e njoftuar te njejten se aprovohet kerkesa e paditeses por per shkak te veshteresive buxhetore nuk jane ne gjendje qe ti behet pagesa e te Ardhurave Personale mujore sipas kontrates me shpresen se kjo ceshtje do te rregullohet shpejte.


Nga ankesa e paditeses drejtuar Komisionit per ankesa te dt. 11.02.2015 vertetohet se paditesja ne afat ligjor iu eshte drejtuar Komisionit per ankesa sipas udhezimit te te paditures por, I njejti komision nuk I ka kthyer pergjegje ne afat ligjor paditeses per cka e njejta eshte detyruar qe t'i drejtohet gjykates per mbrojtje gjyqsore permes padie.

Pretendimet e pales paditse se pagesa e te Ardhurave Personale mujore nuk ka mundur te behet per arsye te mungeses se mjeteve buxhetore , gjykata e mori si irelevante , per arsyes konludimi gjyqsor ka pasuar konform interpretimit te percaktuar me kriteret e kontrates se lart cekur.

Bazuar ne kriteret e kontrates te cekur me larte sipas se ciles punedhensi (tani e paditura) me rastin e kontraktimit te marredhenes se punes ka qene ne dieni per kushtet kontraktuese dhe obligimin qe ka marre nga kontrata konform kriterëve te te njejtes, me dieni dhe pajtimin e plote, e njejta ka pranuar kontraktimin e punes te percaktuar nga kontrata, qka nenkuptom se njekohesisht ka pranuar me vetedije edhe detyrimin per pagesen e te ardhurave personale mujore paditeses. Ndersa e paditura nuk e ka provuar se paditsja I ka shkelur kriteret e kontrates.

Gjykimin e larteshenuar , gjykata e ka konkluduar ne perfillje te dispozites se nenit 154 te Ligjit mbi Marredheniet e Detyrimeve ku parashihet se “kush I shkakton dem tjetrit ka per detyr ta kompenzoj, ne qoftese nuk provon se dem ka lindur pa fajin e tij”, ndersa me dispoziten e nenit 158 te te njejtit ligj parashihet se “fajesia ekziston kur demtuesi I ka shkakuar demin me dashje apo nga pakujdesia”. Ne rastin konkret eshte provuar se paditsja eshte demtuar nga veprimet e te paditures nga se te njejtes nuk iu jane paguar pagat te cilat I takojne ne baze te kontrates mbi themelimin e marredhenies se punes e me kete e paditura I ka shkakuar dem material paditeses ne shumen e cekur ne dispozitiv.

Gjykata vendimin e shprehur ne shprehur proceduralë t'i barte secila pale, e mbeshiteti ne dispoziten e nenit 45



Nga te paraqiturat me larte e ne kuptim nenit 143.1 te LPK-se, u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.179/2015, dt.19.05.2015.



KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte lejuar ankesa, ne afat prej 7(shtat) ditesh, nga dita e pranimut e Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes keshtjese.

Saktesine e pershkrimet e verteton:

(REPUBLIKA E KOSOVES) (REPUBLIC OF KOSOVA)

QEVERIA QENDRORE
KOSOVA
KOSOVIA

